



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 106 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 5 të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 23.10.2021, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Miratimin e Rekomandimit të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve për Rritjen e Nivelit të Tolerancës dhe Përfshirja në Rezultate Përfundimtare Vendvotimin 0906E/01D, për Zgjedhjet për Kryetar Komune 2021

- I. Miratohet rekomandimi i Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, për rritjen e nivelit të tolerancës në njëzetë e dy (22) fletëvotime dhe përfshirja në rezultate përfundimtare vendvotimin Nr. 0906E/01D, për zgjedhjet për Kryetar Komune 2021.
- II. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është rekomandimi i QNR-së.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Duke u bazuar në rekomandimin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR) të datës 23.10.2021, vendvotimi 0906E/01D është hetuar dhe rinumëruar ky vendvotim, dhe pas rinumërimit rezultoi se të dhënat sa i përket barazimit të fletëvotimeve në Formularët e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve - për Kryetar Komune, tejkalojnë nivelin e tolerancës për njëzetë e dy (22) fletëvotime dhe i njëjti nuk mund të procedohet tutje.

Për shkak të tejkalimit të nivelit të tolerancës +/- 3, dhe raportit nga hetimi, rezultoi se fletëvotimet e dëmtuara gjatë ditës të cilat janë të vendosura në zarfin Nr. 1, nuk kanë cenuar votat e hedhura brenda kutisë së votimit dhe rekomandohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që për vendvotimin 0906E/01D për Kryetar Komune, të rritet niveli i tolerancës në njëzet e dy (22) fletëvotime dhe rezultatet e këtij vendvotimi të përfshihen në rezultatet përfundimtare.

Andaj, KQZ-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 23.10.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Datë / Datum	23.10.2021	Referencë/e	
Për/ Za	Komisionin Qendror të Zgjedhjeve		
Nga/ Od	Burim Ahmetaj, Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së		
Tema/ Subjekat	Raport i aktiviteteve të Sekretariatit të KQZ-së		

### Hetimi dhe rinumërimi i vendvotimi 0906E/01D

Gjatë procesit të Pranimit të materialit të ndjeshëm, një numër i vendvotimeve nuk kanë mundur të pranohen si të rregullta. QNR në bazë të procedurave i heton të gjitha vendvotimet e derguara në karantinë dhe nga të gjeturat rezulton se në një rast, Formularët e Rezultateve janë të pranuar në rregull dhe rezulton se janë në rregull mirëpo Zarfi Nr1. me disa fletëvotime të dëmtuara gjatë ditës është në polici.

Sipas vendimit të KQZ-së për hetim dhe rinumërim, ekipi i hetimit në QNR, ka analizuar fletëvotimet për vlefshmërinë e tyre, dhe që është kontrolluar se a janë të vulosura, a janë fletëvotime që i takojnë atij vendvotimit dhe numrat serik a janë të atij vendvotimi. Nga vlerësimi i këtyre kriterëve të lartcekura ekipi i hetimit verteton se fletëvotimet janë të vulosura, përmbajnë numrin e vendvotimit të printuar në fletëvotim dhe numrat serik i takojnë atij vendvotimi. Këto 3 elemente vërtetojnë se nuk është cenuar integriteti i fletëvotimeve.

Më pastaj janë karasuar numri i fletëvotimeve të pranuar në vendvotim me numrin e fletëvotimeve të përdorura me fletëvotimet e papërdorura dhe rezulton se janë pranuar 700 fletëvotime 211 fletëvotime të papërdorura dhe 489 fletëvotime të përdorura. Prej fletëvotimeve të përdorura janë 22 fletëvotime të dëmtuara gjatë ditës, 4 fletëvotime me kusht dhe 463 fletëvotime brenda kutisë së votimit. Numri i fletëvotimeve të hedhura brenda kutisë së votimit është i njëjtë me numrin e nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve. Nga barazimi i tyre rezulton se 22 fletëvotime të dëmtuara gjatë ditës janë marrë nga Policia Hetuese si prova për hetim, ndërsa brenda kutisë së votimi janë hedhur 463 fletëvotime, prej tyre 5 fletëvotime të zbrazëta, 11 fletëvotime të pavlefshme dhe 447 fletëvotime të vlefshme që gjithsejt janë 463 fletëvotime brenda kutisë së votimit.

Fletëvotimet e dëmtuara gjatë ditës, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim, nuk përzihen me fletëvotime brenda kutisë së votimit. Ekipi përpos hetimit, ka pasur për detyrë të bëjë rinumërimin e fletëvotimeve brenda kutisë së votimit dhe nga rinumërimi rezulton se janë 5 fletëvotime të zbrazëta, 11 fletëvotime të pavlefshme dhe 447 fletëvotime të vlefshme. Gjatë

rinumërimin është gjetur se në vendvotim, 1 fletëvotim që i takon Subjektit me numër 160, është numëruar si votë për subjektin nr. 144.

### **Rekomandim nga QNR**

Vendvotimi 0906E/01D është hetuar dhe rinumëruar me vendim të KQZ-së, dhe pas rinumërimin rezulton se të dhënat sa i përket barazimit të fletëvotimeve në FPR për Kryetar Komune, tejkalojnë nivelin e tolerancës për 22 fletëvotime dhe i njëjti nuk mund të procedohet tutje.

**Për shkak të tejkalimit të nivelit të tolerancës +/- 3, dhe raportit nga hetimi, rezulton se fletëvotimet e dëmtuara gjatë ditës të cilat janë të vendosura në zarfin nr. 1, nuk kanë cenuar votat e hedhura brenda kutisë së votimit dhe rekomandohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që për vendvotimin 0906E/01D për Kryetar Komune, të rritet niveli i tolerancës në 22 dhe rezultatet e këtij vendvotimi të përfshihen në rezultatet përfundimtare.**